



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	02.05.2024
REFERENC-Ë:	24/221/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Roto Recycling" Sh.p.k Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 24/211/26/ DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë "Roto Recycling" Sh.p.k Prishtinë - për depon për grumbullimin e letrës dhe plastikes në Obiliq.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së kompanisë "Roto Recycling" Sh.p.k Prishtinë, e cila ka aplikuar për depon për grumbullimin e letrës dhe plastikes në ngastrën kadastrale Nr. P-72614055-01275-1 në Obiliq.

A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Roto Recycling" Sh.p.k Prishtinë, e cila aplikuar për depon për grumbullimin e letrës dhe plastikes në Obiliq, është konstatuar mungon dokumentacioni si në vijim:

- Dëshmia për vlerën financiare investuese të projektit e paraqitur në formë tabelare;
- Kopja e Planit nga Kosova- Ref.

Faqe 2 nga 3



Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë “Roto Recycling” Sh.p.k Prishtinë, me datën 31.01.2024 i është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara janë sjellë në afatin e përcaktuar ligjor.

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, neni 16, me datën 24.04.2024 është mbajtur debati publik.

Bazuar në procesverbalin e dërguar nga Kompania njoftimi për debat publik nuk është bërë në përputhje me ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, neni 16.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr vendim për **Përfundimin e Procedurës Administrative** të kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë “Roto Recycling” Sh.p.k Prishtinë, e cila ka aplikuar për depon për grumbullimin e letrës dhe plastikes në ngastrën kadastrale Nr. P-72614055-01275-1 në Obiliq.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/221/1- ZSP/ /24 datë: 02.05.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Obiliqit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI



Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm
të MMPHI

Faqe 3 nga 3